

VENDIM
Nr. 1010, datë 13.11.2013

**PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË BORDIT TË MENAXHIMIT PËR AUTORITETIN
RRUGOR SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 8 të ligjit nr. 10 164, datë 15.10.2009 “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Emërimin e anëtarëve të bordit të menaxhimit për Autoritetin Rrugor Shqiptar, i cili të kryesohet nga z. Eduart Seitaj, përfaqësues i Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, dhe të ketë në përbërje këta anëtarë, përfaqësues të institucioneve të mëposhtme:

- a) Z. Erjon Luçi, Ministria e Financave;
- b) Z. Etien Xhafa, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;
- c) Z. Enea Hoti, ministri i Shtetit për Çështjet Vendore;
- ç) Z. Luigj Aleksi, Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë;
- d) Z. Ilir Zhilla, Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë;
- dh) Z. Faruk Kaba, Shoqata Shqiptare e Inxhinierëve Konsulentë.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga shpenzimet e planifikuara për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

3. Vendimi nr. 484, datë 23.6.2010 i Këshillit të Ministrave “Për emërimin e anëtarëve të bordit të menaxhimit për Autoritetin Rrugor Shqiptar”, i ndryshuar, shfuqizohet.

4. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama